

# **AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR “ NOVASSETS “ SHPK**

Në Tiranë, sot më datë 26.09.2024, I poshtëshënuari :

Rino Subashi i datelindjes 02.01.1995, shtetas Shqiptar ,mbajtes i Pasaportes Nr. J50102062Q me cilësinë e “ortakut themelues” deklaroj se me vullnet të lirë të plotë, mbështetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit“, i ndryshuar, krijoj shoqërinë tregtare me përgjegjësitëkuizuar“NOVASSETS”shpk

Neni 1  
Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin **“NOVASSETS “ shpk** , dhe formë ligjore:  
“Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2  
Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Neni 3  
Selia

Shoqëria e ka seline në adresë:  
Bulevardi Zhan Dark Pallati 3 Shkalla 2 Apartamenti 10 Tirane.

Neni 4  
Objekti i veprimitarise

- Investime ne fusha te ndryshme ndertimore
- Ndertim –Projektim-Investim dhe te gjitha llojet e tjera te tregtise
- Eksport –Import te çdo lloji materiali ndertimi .
- Eksport -import makineri te cdo lloji , impiante industriale, atrecatura si dhe cdo tregti persa i perket mjeteve te transportit apo mjete ndertimi , produkte te tyre si dhe cdo mjet i cdo tonazhi apo lloji pa kufizim .
- Zhvillues ne fushen e turizmit, hoteleri, restorante etje.
- Blerje –shitje Marketing prona te luajtshme e te paluajtshme
- Eksport –Import te pajisjeve mjekesore e medikamenteve te ndryshme te cdo lloji, te pajisjeve kompjuterike dhe elektronike , te makinerive te ndryshme per transport individual dhe publik, te produkteve ushqimore , industriale kozmetike etj. -Konsulencë dhe informacion mbi lehtesirat fiskale , konsulencë mbi problematikat fiskale , kontabile dhe bilancin , Sherbime kontabiliteti ,mbajtje te llogarive standartete kontabilitetit shqiptare , dhe te tjera raporteve financiare te kerkuara nga aksioneret , keshilla profesionale ne lidhje me strukturen , paraqitjen dhe zbulimin e pasqyrave financiare , ndjekje e procedurave te likujdimit dhe falimentit te shoqerise . -Keshillim ligjor dhe financiar vecanarisht keshillim

ne fushen e se d rejtes tregetare , taksave , prokurimeve publike , koncensionet dhe privatizimet , pronesine intelektuale dhe te drejtat e autorit , si dhe cdo fushe te se drejtes ne per gjithesi .

Neni 5  
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj pa afat.

Neni 6  
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshtë 100.000 le'kë.

Kapitali i mesiperme eshte nënshkruar nga "ortaku i vetem i shoqerise :

Rino Subashi, zoterues i 1 kuote qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitali themeltar te shoqerise;

Neni 7  
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;

b) shitblerjes;

c) trashëgimisë;

ç) dhurimit;

d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligji.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Korriketare të Biznesit, sipas nenit 13 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Komunitare të Biznesit".

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme vetëm me rrugë trashëgimie. Transferimi i kuotave si ortakëve të shoqërisë ashtu edhe për personat e tjerë jashtë shoqërisë është i kushtëzuar me miratimin e Asamblesë.

Neni 8  
Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;

b) ndryshimet e statutit;

c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;

ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendor në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;

dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;

e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;  
gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;  
h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;  
i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rr Ethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9  
Administrimi

Administrator i shoqërisë eshtë:

- Rino Subashi, i datelindjes 02.01.1995, shtetas Shqiptar ,mbajtes i Pasaportes Nr. J50102062Q, emëruar ne këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtritje.

Neni 10  
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11  
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 kopje, në gjuhën shqipe, me përmnjatje dhe vlera te njëjta juridike.  
Akti i mësiperm pasi miratohet në parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues të shoqërisë tregtare  
"NOVASSETS " shpk , nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

**ORTAKU THEMELUES**

Rino Subashi

A handwritten signature in blue ink, reading "Rino Subashi", is written diagonally across the page below the typed name. It is enclosed in a large, roughly drawn oval shape.